

## RELACION TEKNIK

**Objekti: "Mirëmbajtje me performancë e segmentit rrugor Ura e Gjormit – Brataj – Ura e Laskos"**


**Aksi rrugor : Ura e Gjormit – Brataj – Ura e Laskos**

Gjatësia: 27.2 km

Gjerësia: Gjerësia mesatare e asfaltuar është 7 m, bankina të pashtuara 0.75 m nga të dy anët.

Pika e Fillimit: Ura e Gjormit

Pika e Mbarimit: Ura e Laskos



Aksi rrugor Ura e Gjormit – Brataj – Ura e Laskos është një aks i rëndësishëm kombëtar. Është pjesë e aksit kombëtar të Lumit të Vlorës që lidh një numër të madh fshatrash me pjesën tjetër të vendit dhe me zemrën e Bregdetit Jonian. Nga pikpamja social – ekonomike paraqitet me rëndësi të veçantë, pasi i shërbën një komuniteti të madh banorësh. Ai kalon në një numër të madh qendrash të banuara ku ka zhvillim të madh të aktivitetit bujqësor e blegtoral si dhe të agroturizmit.

Ruga shtrihet në një terren fushor e kodrinor me parametra planimetrikë përgjithësisht të disfavorshme. Parametrat alimetrikë janë pjesërisht të mira. Ruga është nën rikonstruksion nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Gjerësia e asfaltuar është mesatarisht 7 m me bankina të pashtuara 0.75 m nga të dy anët.

Konkretnisht segmenti rrugor Ura e Gjormit – Brataj – Ura e Laskos me gjatesi 27.2 km ka përfunduar dhe është në periudhë garancie difektesh, kurse segmenti Ura e Laskos – Kuc 6,7 km është nën rikonstruksion dhe punimet nuk kanë përfunduar.

Nëpërmjet këtyre projekteve është bërë zgjerimi i rrugës, përmirësimi i elementeve gjometrikë të rrugës, ndërtimi i veprave të reja të artit, ndërtimi i shtresave të reja rrugore, kompletimi me sinjalistikë rrugore etj. Paketa e shtresave asfaltike është 6 cm binder dhe 4 cm asfaltobeton.

Nga pikëpamja e Mirëmbajtjes Dimërore rruga nuk paraqet probleme të veçanta. Reshet e dëborës janë të rralla dhe jo intensive. Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është evident në rastet e temperaturave negative por nuk është fenomen sistematik dhe shqetësues.

Deri në datën 09.09.2022 objekti është brenda periudhës së garancisë së defekteve dhe gjatë kësaj periudhe do të kryhen vetëm punime të karakterit rutinë si në vijim:

1	Pastrimi i kanaleve dhe kunetave
2	Pastrimi tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore
3	Pastrimi i vegjetacionit
4	Pastrimi i karrehatës nga aluvionet dhe materiale të tjera

Për periudhën tjetër punimet e mirëmbajtjes rutinë do të konsistonë në:

1	Pastrimi i kanaleve dhe kunetave
2	Pastrimi tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore
3	Mbushja dhe nivelimi i bankinave
4	Pastrimi i vegjetacionit
5	Pastrimi i karrehatës nga aluvionet dhe materiale të tjera
6	Riparimi i gropave të asfaltit
7	Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt
8	Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale
9	Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike)
10	Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit

Gjatë kësaj periudhe mund të lindë nevoja për punime rehabilitimi/periodike.

Përgatiti:

Inxh. Ariana Hasani

Inxh. Altin Sula

Inxh. Genti Raça